


## Takimi virtual i Juristëve në Diasporë më 4 Prill



Të nderuar pjesëmarrës në Takimin e Juristëve në Diasporë në datën 4 prill. Ju njoftojmë se, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 dhe masave të marra për parandalimin e përhapjes së virusit, takimi do të zhvillohet online. Agjencia Kombëtare e Diasporës do t'ju njoftojë në vijim për modalitetet e zhvillimit të kësaj veprimtarie.

## Aplikacioni informues “Diaspora Shqiptare”



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## Autorët e javës nga Takimi i Shkrimtarëve të Diasporës



**Entela Tabaku** lindi në Shkodër ku studioi violinë në shkollën e mesme artistike “Prenkë Jakova” dhe gjuhëletërsi në universitetin “Luigj Gurakuqi”. Më 2014 mbrojtë doktoraturën në gjuhësi italiane pranë Universitetit të Stokholmit, ku punoi si ligjëruese e italishtes. Nga viti 2017 punon si ligjëruese e shqipes në Universitetin e Upsalës. Është autore e disa librave me poezi dhe veprave studimore në italishte dhe shqip si dhe ka sjellë në shqip një sërë veprash nga suedishtja.



**Rudolf Marku** lindi në Lezhë dhe është autor i disa vëllimeve me poezi, romaneve, shkrimeve publicistike dhe përkthyes i shumë autorëve të njohur të shekullit XX. Romani i tij “Tre divorcet e zotit Viktor N.” është fitues i çmimit “Kadare” për vitin 2015. Është nderuar me çmimin e Poezisë Evropiane në Berlin në vitin 2007, “Naim Frashëri”, “At Zef Pllumi”, “PEN” etj. Poezitë e tij janë përkthyer dhe botuar në shumë gjuhë të botës dhe përfshirë në shumë antologji letrare prestigjioze.

## “Raporto” problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

## KKD / Mark Gjonaj propozon pezullimin e taksave për bizneset e vogla



Gjendja e krijuar nga pandemia globale COVID-19 në New York të SHBA-së ka bërë që njerëzit të izoloohen dhe shumë biznese të ndalojnë punën e tyre. Këshilltari i Bashkisë së New York-ut dhe njëkohësisht kryetari i Këshillit Koordinues të Diasporës, Mark Gjonaj ka reaguar për këtë situatë në mënyrë që të merren masa për lehtësimin e bizneseve të vogla. Në një intervistë për një televizion amerikan “Bronxnet”, ai propozon pezullimin e taksave për biznesin e vogël si një masë lehtësuese për ekonominë në kushtet e pandemisë botërore. “Bizneset e vogla janë thelbësore për ekonominë e NYC. Ata kanë nevojë për lehtësim tani, kjo nuk ka të bëjë me zhvillimin e tyre, por me mbijetesën”, – ka thënë Gjonaj.

## Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digjitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin “e-Albania”.

## KKD / Ardian Lekaj: Sipërmarrjet e vogla duan orientim në përshtatje



Ardian Lekaj, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës flet për qëndrimin e tij në këtë situatë pandemie, si shihet kriza aktuale shëndetësore, ekonomike dhe shoqërore. “Shëndeti i individit, është ushqimi i ekonomisë! Ky duhet të jetë fokusi i kamerës së çdo vendi të globit sot. Po ecim në kohën e paparashikuar dhe të papritur, pikërisht kur vëmendja tërhiqet nga strategjia afatgjatë e BE-së 2050, për një ekonomi të gjelbër dhe inovative. Duket si një histori e pabesueshme...” shprehet Lekaj.

## Deklaratë nga Këshilli Koordinues i Diasporës



### Deklaratë

Duke marrë parasysh situatën e pandemisë së shkakuar nga COVID-19, Këshilli Koordinues i Diasporës:

- I bën thirrje klasës politike në Shqipëri dhe Kosovë që të tregoj maturinë e duhur në menaxhimin e kësaj situatë të paprecedent.
- I bën thirrje qeverisë së Kosovës që të punoj në menaxhimin e kësaj situatë të vështirë duke anashkaluar dallimet politike. Çdo lloj destabilizimi i kësaj qeverie në këto kushte shtëpie në destabilizim të shtetit të Kosovës e cila mund të jetë me pasojë fatale. Interesi kombëtar kërkon nga udhëheqësit politik maturi dhe pjekuri për të mirën e kombit.
- Fton qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës që të përgatisin paketa fiskale konkrete në shërbim të bizneseve dhe popullatës. Gjithashtu fton këto qeveri që të komunikojnë dhe bashkëpunojnë me shumë me bizneset në mënyrë që të bëhet e mundur puna e tyre në shërbim të konsumatorëve në të gjitha rastet kur kjo nuk sjell rezikimin e shëndetit të punëtorëve dhe konsumatorëve.
- Fton qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës që specialistëve të shëndetësisë t'u jepet më shumë hapësirë në media në mënyrë që t'i japin popullit mesazhe profesionale për menaxhimin sa më lehtë të situatës. Në vendet e zhvilluara ku ne jetojmë ekspertë të fushave të shëndetësisë dhe atyre sociale si dhe autoritetet lokale po luajnë një rol të rëndësishëm në komunikimin me qytetarët, gjë që nuk po e shohim sa duhet në vendin tonë.
- Falenderon të gjithë profesionistët e fushës së mjekësisë në vendet tona dhe kudo ata ndodhen nëpër botë për kontributin shembullor në menaxhimin e kësaj situatë. Inkurajon bashkëpunimin mes profesionistëve shqiptarë të fushës së mjekësisë kudo ndodhen dhe ndarjen e këshillave profesionale me komunitetet tona në diasporë në mënyrë që menaxhimi i situatës të jetë sa më i lehtë për të gjithë.
- I bën thirrje të gjithë shqiptarëve kudo ndodhen t'u binden rregullave të vendosura nga qeveritë në vendet ku jetojnë si e vetmja mënyrë për menaxhimin e situatës.
- Fton të gjithë bashkëpunuesit që kanë pyetje rreth situatës të kontaktojnë institucionet përgjegjëse në vendet ku jetojnë, ambasadat dhe konsullatat si dhe në Këshill Koordinues i Diasporës.
- Fton të gjithë shqiptarët kudo ndodhen të kenë kujdes dhe ta përkrahin njëri-tjetrin në mënyrë që ta kalojnë sa më lehtë këtë situatë të paprecedent.

## COVID-19 RREGULLAT E REJA

- Ndalohen aktivitetet sportive, kulturore, konferenca, koncerte, tubime dhe dëgjesa publike deri më datë 3 Prill
- Mbyllet diskot, lokale nate, ambiente për argëtim, si qendra sociale, palestira, pishina deri më 3 Prill
- Restorantet, baret të ofrojnë shërbime për qytetarët duke respektuar distancën prej së paku 2 m nga tavolinat dhe së paku 1 metër qytetarët nga njëri tjetri.
- Pezullohen të gjithë procedurat për konkurset për procedurat për punësim
- Mbyllet çerdhet dhe institucionet arsimore deri më 23 Mars
- Ndalohet grumbullimi i pacientëve, shoqëruesve dhe familjarëve në qendra shëndetësore/spitale ku bëhen vizita ambulatorie.
- Kufizohet lëvizja e udhëtarëve me mjetet e transportit publik qytetas, rrethqytetas dhe ndër-qytetas për periudhën deri më 3 prill 2020
- Ndalohen lëvizjet e udhëtarëve me mjetet e transportit ajror dhe detar drejt Italisë.

Për të parandaluar përhapjen e koronavirusit në vend: **KORONAVIRUS**

- Pezullohen fluturimet dhe udhëtimet në rrugë detare me verilin e Italisë, me të gjithë zonat e kuqe, i cili do të monitorohet me rigorozitet nga strukturat shëndetësore. Ky vendim është i shoqëruar edhe me masa administrative për këdo e thyen këtë rregull.
- Mbyllet institucionet arsimore për një periudhë 2 javore.
- Anuloohen grumbullimet masive, aktivitetet sportive, kulturore, konferenca, dëgjesa publike deri më datë 3 Prill.